

Vula e dygjuhësisë e shtetit të Nju-Jorkut


Mundeni të flisni më shumë se një gjuhë?
Apo po mësoni një gjuhë tjetër? Flisni me shkollën tuaj
për vulën e dygjuhësisë së shtetit të Nju-Jorkut!

Çfarë është vula e dygjuhësisë e shtetit të Nju-Jorkut (NYSSB)?

Vula e dygjuhësisë e shtetit të Nju-Jorkut (NYSSB) njeh të diplomuarit e shkollave të mesme që mund të dëgjojnë, flasin, lexojnë dhe shkruajnë në anglisht dhe në të paktën një gjuhë tjetër. NYSSB mund t'i jepet çdo nxënësi të vitit të fundit që diplomohet dhe që ka përmbushur kërkesat për diplomë dhe mund të dëshmojë aftësitë e tij në anglisht dhe në një gjuhë tjetër. Përfituesve u vendoset një vulë në diplomën e tyre dhe u jepet një medaljon gjatë ceremonisë së diplomimit.

Cilat janë përfitimet e NYSSB-së?

- Përforcon transkriptin dhe diplomën e shkollës së mesme
- Rrit konkurrueshmërinë e aplikimeve për universitet
- Ndihmon në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës amtare
- Përgatit për karriera në një shoqëri globale
- Vlerëson identitetin kulturor dhe aftësitë dygjuhësore
- Mundëson marrjen e krediteve për njohuri të mësuara më parë në kolegje të zgjedhura



Kush kualifikohet?

Mund ta fitojë çdo nxënës i shkollave që ofrojnë programin e vulës së dygjuhësisë së shtetit të Nju-Jorkut që di ose po mëson anglisht dhe një gjuhë tjetër. Përfshihen nxënësit që flasin një gjuhë tjetër në shtëpi ose që studiojnë një gjuhë të huaj në shkollë. Shkollat duhet të regjistrohen për pjesëmarrje përpara muajit janar të çdo viti.

Si mund ta fitoj NYSSB?

- ✓ Plotësoni të gjitha kërkesat për **diplomë Regents të shtetit të Nju-Jorkut**

DHE

- ✓ Ftoni të paktën **tre pikë në anglisht** dhe
- ✓ Fitoni të pakën **tre pikë në një gjuhë tjetër të huaj**.



Vizitoni bit.ly/NYCPS-Biliteracy për më shumë informacion.

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të fituar këto pikë, si për shembull: nota të larta në kurset e gjuhës, rezultate të mira në provime, ose përfundimi i Projektit Përmbyllës Capstone të Dytëgjuhësisë.

Si mund ta di nëse shkolla ime e ofron vulën e dygjuhësisë?

Mund të mësoni nëse shkolla juaj e ofron këtë program duke vizituar schools.nyc.gov/NYSSB.

Çfarë ndodh nëse shkolla ime nuk e ofron NYSSB-në?

Flisni me mësuesin e gjuhës së huaj, koordinatoren e prindërve ose drejtorin e shkollës për të mësuar hapat e parë, ose dërgoni email në NYSSB@schools.nyc.gov.

A jep NYSSB kredite për kolegji?

Po, disa kolegje ofrojnë kredite ose vendosje në një nivel më të avancuar për NYSSB-në.

Mësoni se cili kampus i CUNY ofron kredite për njohuri të mëparshme: bit.ly/CUNYNYSSB

Kontaktoni kolegjin ose universitetin ku dëshironi të studioni për më shumë informacion.

Keni pyetje? Kontaktoni shkollën tuaj ose dërgoni email në NYSSB@schools.nyc.gov.